

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6944
E shtunë, 15 korrik 2023
Çmimi 0.40 €

Belgjika: Kosova duhet të jetë anëtare e asociuar e Asamblesë Parlamentare të NATO-s | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZHVILLIMET E FUNDIT NË VEND E SHTYJNË SËRISH OPOZITËN TË REAGJË NDAJ QEVERISË KURTI | FAQE 4-5

OPOZITA KA FRIKË SE ME QEVERINË KURTI SITUATA MUND TË PËRSHKALLËZOHET EDHE MË KEQ



Partitë opozitare kanë reaguar edhe të premtën për ngjarjen e një dite më parë në Kuvendin e Kosovës, në të cilin deputetët dhe ministrat, përpos me fjalë, u

përplasën edhe me grushte. Liderët e opozitës kanë frikë se me qeverinë Kurti situata mund të përshkallëzohet edhe më keq. Sipas tyre, kjo qeveri nuk ka më

asnjë lloj kredibiliteti për ta qeverisur vendin pasi është duke prishur edhe marrëdhëniet me aleatët e Kosovës, ShBA-në dhe BE-në

AKTUALE



KUVENDI I SHQIPËRISË HAP RRUGËN PËR ARRESTIMIN E AHMETAJT | F. 2

POLICIA BASTIS PRONAT E DY ZYRTARËVE TË LV-SË, SEKUESTRON 60 MIJË EURO | F. 3

IKSHPK-JA JEP DHJETË REKOMANDIME PËR KUJDES NGA TEMPERATURAT | F. 6

EKONOMI



KURTI INSPEKTOI PUNIMET NË ZGJERIMIN E RRUGËS PRISHTINË - PODUJEVË | F. 8

KËNGËTARËT PËR GJASHTË MUAJ PAGUAN TATIM 1.2 MILION EURO | F. 8

SPORT



SHABANI: DUKAGJINI KUALIFIKOHET NË RAUNDIN TJETËR | F. 10



PAGA MINIMALE RRITET NË 264 EURO, PËRJASHTOHEN VETERANËT E UÇK-së | FAQE 8

KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 419 POLICË TË RINJ | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: Afër 300 fëmijë vdiqën gjatë kalimit të Mesdheut

Nju-Jork, 14 korrik - Kombet e Bashkuara thanë se 289 fëmijë kanë vdekur gjatë pjesës së parë të vitit 2023 gjatë tentimit për ta kaluar Detin Mesdhe për në Evropë. Kjo shifër është dyfish me vdekjet e regjistruara në periudhën e njëjtë të vitit 2022, tha agjencia e OKB-së për fëmijët, UNICEF. Kjo agjenci kërkoi që fëmijëve që kërkojnë mbrojtje në Evropë t'u ofrohet rrugë e sigurt.

Venera Knaus, udhëheqëse në UNICEF për migrim dhe zhvendosje, tha se shifrat reale ka shumë të ngjarë të jenë më

të larta për shkak se gjatë fundosjeve të anijeve në Mesdheun qendror shpesh nuk ka të mbijetuar ose viktimat nuk regjistrohen. "Numri i fëmijëve që kanë humbur jetën e tyre në tentim për ta kaluar Detin Mesdhe për të arritur në Evropë është dyfishuar në gjysmën e parë të këtij viti krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar", tha ajo.

"Në gjashtë muajt e parë të këtij viti ne vlerësojmë se 11 600 fëmijë e kanë kaluar detin - sërish, pothuajse dyfish më shumë sesa në periudhën e

njëjtë më 2022".

UNICEF-i tha se në tre muajt e parë të vitit 2023 rreth 3 300 fëmijë - 71 për qind e të gjithë fëmijëve që kanë arritur në Evropë përmes rrugës mesdhetare - kanë qenë të pashoqëruar apo të ndarë nga familjarët e tyre. Kjo shifër, po ashtu, është tri herë më lart sesa në vitin paraprak. "Këta fëmijë duhet ta dinë se nuk janë vetëm. Liderët botërorë duhet menjëherë të veprojnë për të treguar se jeta e fëmijëve është e vlefshme, të veprojnë drejt një zgjidhjeje efektive për këtë situatë", tha Knaus.



Kuvendi i Shqipërisë hap rrugën për arrestimin e Ahmetajt

TIRANË, 14 KORRIK - Kuvendi i Shqipërisë ka hapur rrugën për arrestimin e ish-zëvendëskryeministrit Arben Ahmetaj. Gjatë seancës plenare, 117 deputetë mbështetën kërkesën e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit (SPAK) për arrestimin e Ahmetajt dhe lejimit të kontrollimit të banesës së tij. Nga 120 deputetë të pranishëm në kohën e votimit, tre deputetë abstenuan. SPAK-u e akuzon Ahmetajn për korrupsion, pastrim parash dhe mosdeklarim të pasurisë. Në seancën plenare u lexuan raportet që janë përgatitur nga përfaqësuesit e opozitës dhe ata në pushtet për rastin e Ahmetajt. Kryetari i grupit parlamentar i Partisë Demokratike në opozitë, Gazmend Bardh, i bëri thirrje Ahmetajt që të bëhet bashkëpunëtor i drejtësisë. "Nëse bëhet secili ministër që është në burg duhet t'i lirojë vendin kreut të qeverisë. Ideatori nuk është as Damian Gjoknuri as Lefter Koka, por [kryeministri i Shqipërisë] Edi Rama", tha Bardhi.

Ditë më parë Arben Ahmetaj është larguar nga Shqipëria. "Personi që siguroi daljen e tij jashtë Shqipërisë



është Rama. Rama ta dorëzojë para drejtësisë Ahmetajn. Ai nuk mund të arratiset me paratë e qytetarëve shqiptarë. Secili prej nesh kolegë duhet të ketë një qëllim: Edi Rama ta dorëzojë para drejtësisë Arben Ahmetaj", tha Bardhi, pa dhënë dëshmi se

kryeministri shqiptar është i përfshirë në largimin e Ahmetajt nga Shqipëria.

Arben Pëllumbi nga Partia Socialiste në pushtet iu përgjigj akuzave të Bardhit. "Nuk jemi as gjykatë, as prokurorë për të dhënë vendime. Kemi para një

raport të paraqitur nga organi i akuzës, i cili duhet të ndeshet në gjykatë me personin nën hetim dhe gjykata është i vetmi organ që duhet ta japë vendimin final. Deri në atë stad, ne duhet t'i njohim prezumimin e pafajësisë. Ne nuk jemi këtu për

të dhënë vendime politike. [Bardhi] Përmendi plot emra, përmendi shumë herë kryeministrin e vendit, që në raportin e SPAK-ut nuk ekziston gjëkundi", tha Pëllumbi.

Kryeministri Edi Rama ishte i pranishëm në seancën e së premtes, por nuk bëri asnjë deklaratë në Kuvend.

Ish-zëvendëskryeministri Ahmetaj reagoi përmes llogarisë në "Facebook" në kohën kur zhvillohej seanca lidhur me kërkesën e SPAK-ut. "Luigjit të 16 iu dhanë katër ditë kohë para se t'i pritej koka, mua as 24 orë. Dikush më tha 'të duan në burg'", ka shkruar ai.

Deri më tani nuk dihet vendndodhja e Ahmetajt, por avokati i tij Henrik Ligori njoftoi se ai ndodhet në Angli, pranë vajzës së tij.

I pyetur se kur do të kthehet, ai u përgjigj: "Do të kthehet kur të ketë liri".

Arben Ahmetaj ka mbajtur disa pozita të rëndësishme gjatë dhjetë vjetëve të qeverisjes së kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama. Ai ka qenë drejtues i Drejtorisë së Tatimeve, ministër i Ekonomisë dhe Sipërmarrjes, ministër i Financave, zëvendëskryeministër dhe ministër i Rindërtimit.

India bëhet gati për misionin historik në Hënë

NEW DELHI, 14 KORRIK - India do ta nisë misionin e saj të tretë drejt Hënës, në tentim për t'u bërë vendi i parë që arrin pranë polit jugor të Hënës, i cili nuk është eksploruar shumë.

Anija Chandrayaan-3 është nisur të premten në orën 10:05 nga qendra hapësinore Sriharikota. Ajo do të arrijë në Hënë më 23 dhe 24 gusht, thanë

zyrtarët e agjencisë hapësinore. Nëse do të ketë sukses, India do të jetë vetëm vendi i katërt që do të arrijë një zbarkim të kontrolluar në Hënë, pas ShBA-së, ish-Bashkimit Sovjetik dhe Kinës.

Si iniciativë e tretë në programin e eksplorimit hënor të Indisë, Chandrayaan-3 pritet t'i vazhdojë sukseset e misioneve

të mëparshme në Hënë.

Ky mision vjen 13 vjet pas misionit të parë të Indisë në Hënë në vitin 2008, që kreu "kërkimin e parë dhe më të hollësishëm të ujit në sipërfaqen hënore dhe zbuloi se Hëna ka një atmosferë gjatë ditës", tha Mylswamy Annadurai, drejtor i projektit të Chandrayaan-1.



Belgjika: Kosova duhet të jetë anëtare e asociuar e Asamblesë Parlamentare të NATO-s

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kreu i delegacionit belg në Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), Theo Francken, ka thënë se Belgjika është pro anëtarësimit të Kosovës në AP të NATO-s si anëtare e asociuar. Francken, bashkë me një delegacion nga Parlamenti Federal i Belgjikës, u takuan të premten me delegacionin e Kuvendit të Kosovës në AP të NATO-s. "Kosova mund dhe

duhet të jetë anëtare e asociuar e Asamblesë Parlamentare të NATO-s. Ky do të ishte një hap i mirë i integritimit. AP-ja e NATO-s e ka të rëndësishme të diskutojë për stabilitetin dhe sigurinë në Ballkanin Perëndimor. Kjo mbetet prioritet për ne", ka thënë Francken në konferencën për medie pas takimit.

Aktualisht Kuvendi i Kosovës është pjesë e kësaj Asambleje Parlamentare si "delegacion vëzhgues", njëjtë si Australia, Egjipti, Japonia, Koreja e Jugut, Kazakistan, Palestina dhe Tunizia. Ndërsa, Shqipëria, Mali

i Zi, Maqedonia e Veriut janë delegacione anëtare.

Nëse Kosova bëhet anëtare e këtij organi si delegacion i asociuar, ajo do t'i bashkohej Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës nga rajoni.

Vizita e delegacionit belg vjen në një kohë tensionesh në veri të Kosovës, shkaku i të cilave NATO ka angazhuar 700 trupa shtesë në Kosovë, përveç 4 000 trupave që janë të dislokuara në Kosovë. Gjatë konferencës për medie, përfaqësuesi i delegacionit të Kuvendit të Kosovës, deputeti Driton Hyseni nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, shprehu falënderimin për përkrahjen nga delegacioni i Belgjikës. Ai tha se tre deputetët e Parlamentit të Belgjikës konfirmuan se e përkrahin Kosovën për integrim në Bashkim Evropian dhe NATO, ashtu që "përmjend Kosova të mos ndihet e lënë anash, por të jetë pjesë e familjes së vlerave evropiane, ashtu siç jemi".

Delegacionin belg e ka prituri në takim edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i cili ka vlerësuar përkrahjen e vazhdueshme që Belgjika ka



dhënë ndër vite për Kosovën.

Në takim me parlamentarët belgë u bisedua për zhvillimet e përgjithshme politike në vend e rajon, raportet e shkëlqyera dypalëshe dhe mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit të ndërsjellë.

Konjufca pasi i njoftoi mysafirët me punën, të arriturat dhe synimet e legjislativit, vlerësoi lart përkrahjen e vazhdueshme që Belgjika i ka dhënë ndër vite Republikës së Kosovës në të gjitha proceset e shtetndërtimit

dhe kërkoi njëherësh vazhdimin e mbështetjes ndaj shtetit tonë në rrugën euroatlantike dhe të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare.

Parlamentarët belgë e falënderuan kryetarin e Kuvendit për pritjen dhe, po ashtu, shprehën gatishmërinë për thellimin e mëtutjeshëm të bashkëpunimit ndërparlamentar, si dhe në fusha të tjera me interes të përbashkët ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës së Kosovës.



Policia bastis pronat e dy zyrtarëve të LV-së, sekuestron 60 mijë euro



PRISHTINË, 14 KORRIK - Policia e Kosovës i ka bastisur dy lokacione, prona të dy personave të dyshuar, F. M. dhe H. M., në të cilat ka sekuestruar një shumë të konsiderueshme parash, njoftoi Prokuroria Speciale e Kosovës më 13 korrik. Raportohet se pronat e bastisura janë të Faruk Mujkës, kryeshef i "Ibër Lepencit" dhe Hysen Muzilukajt, këshilltar i ministrit të Bujqësisë, Faton Peci. Prokuroria Speciale njoftoi se



"ekziston dyshimi i arsyeshëm se të pandehurit F. M. dhe H. M., në cilësi të personave zyrtarë, me dashje kanë shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar me qëllim të përfitimit të dobisë së kundërligjshme pasurore për vete apo për tjetrin, kanë tejkaluar kompetencat e tyre zyrtare dhe nuk i kanë respektuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre që të ushtrojnë funksionin e tyre në bazë të ligjit". "Gjatë bastisjes në



njërin lokacion, ndër të tjera është gjetur dhe sekuestruar shuma e të hollave prej gjashtëdhjetë mijë eurosh (60 000.00)", ka njoftuar Prokuroria Speciale.

Prokuroria Speciale shtoi se lidhur me këtë rast, në maj të

vitet 2022, kishte pranuar informacione rreth dyshimeve për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar nga dy persona, në atë kohë pjesë e strukturave udhëheqëse në komunën e Mitrovicës së Jugut. Në fillim të këtij muaji ndaj dy të

dyshuarve ishte ngritur kallëzim për "keqpërdorim të detyrës apo autoritet zyrtar". Sipas Prokurorisë, akuzat kanë të bëjnë me kohën sa të dyshuarit ishin pjesë e udhëheqjes në komunën e Mitrovicës së Jugut më 2021.

Verë përmytjesh ekstreme nëpër botë

PARIS, 13 KORRIK - Përmytjet katastrofike nëpër botë po nxisin paralajmërime për krizë klimatike teksa komunitetet po i vuajnë pasojat e motit ekstrem të korrikut.

Shirat e rrëmbyeshëm kanë vërshuar shtëpi dhe kanë shkaktuar dëme të gjera në luginën e Hadsonit, në Nju-Jork, përderisa në Kinë mijëra njerëz janë zhvendosur nga

shtëpitë e tyre.

Në Spanjë njerëzit janë parë duke u kapur pas automjeteve dhe pemëve për t'u ikur ujërave vërshues, ndërsa shteti verior i Hishamal

Pradeshit në Indi, ku rrëshqitjet fatale të dheut bllokuan rreth 700 rrugë, përmytjet shkatërruan një urë dhe i mbushën rrugët plot rrënoja.





ZHVILLIMET E FUNDIT NË VEND E SHTYJNË SËRISH OPOZITËN TË REAGJË NDAJ QEVERISË KURTI

Opozita ka frikë se me qeverinë Kurti situata mund të përshkallëzohet edhe më keq

Partitë opozitare kanë reaguar edhe të premtën për ngjarjen e një dite më parë në Kuvendin e Kosovës, në të cilin deputetët dhe ministrat, përpos me fjalë, u përplasën edhe me grushte. Liderët e opozitës kanë frikë se me qeverinë Kurti situata mund të përshkallëzohet edhe më keq. Sipas tyre, kjo qeveri nuk ka më asnjë lloj kredibiliteti për ta qeverisur vendin pasi është duke prishur edhe marrëdhëniet me aleatët e Kosovës, ShBA-në dhe BE-në

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 14 korrik - Partitë opozitare kanë reaguar edhe të premtën për ngjarjen e një dite më parë në Kuvendin e Kosovës, në të cilin deputetët dhe ministrat, përpos me fjalë, u përplasën edhe me grushte. Kritikën pas publikimit të disa përgjimeve, në të cilat ishte përfshirë shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet, Mimoza Kusari-Lila, rritën tensionet në seancën e Kuvendit të Kosovës më 13 korrik.

Opozita ka drejtuar akuza të ndryshme ndaj qeverisë Kurti, duke theksuar se kjo qeveri po koordinohet me Radojçiqin për marrjen e vendime në dëm të interesave të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës.

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blerta

Deliu-Kodra dhe koordinatori i Departamentit për Financa në kuadër të KQM-së, Arben Mustafa, të premtën në një konferencë për medie i kanë denoncuar vendimet e partisë në pushtet që ndodhën një ditë më parë në Kuvendin e Kosovës, përmes të cilave në një anë përjashtojnë veteranët e UÇK-së nga përfshirja në pagën minimale dhe, në anën tjetër, në themelimin e Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës në Kosovë, kanë zgjatur afatin kohor të hetimit deri më 31 dhjetor të vitit 2000.

Deliu-Kodra ka thënë se nga 12 qershori, kur në Kosovë ka hyrë NATO dhe OKB, nuk ka pasur as luftë dhe as krime që mund t'i përvishen UÇK-së, siç ka pretenduar Serbia, e sot, fatkeqësisht, edhe qeveria e Albin Kurtit. "Serbia ka dërguar me mijëra dokumente e fabrikime kundër UÇK-së në Hagë. Përmes kalimit të këtij

ligji, në këtë lloj forme, qeveria i ka përforcuar këto akuza kundër UÇK-së. Kryeministri Kurti ka mashtruar në deklarimin e tij publik mbrëmë, duke iu drejtuar qytetarëve se kohëzgjatja e hetimit të këtij instituti shtrihet vetëm gjatë luftës në Kosovë, '98-'99. Ky është një mashtrim i radhës. Kryeministri deklaroi në 'Facebook' ndryshe ndërsa, në fakt, kohëzgjatja e hetimit të këtyre krimeve është deri në 31 dhjetor të vitit 2000", ka thënë Deliu-Kodra.

Ajo e ka quajtur këtë vendim të qeverisë si skandal i radhës. "Cilat janë ato krime të cilat kanë ndodhur pas mbarimit të luftës në Kosovë dhe për çfarë krime po flet ky kryeministër, i cili, bashkë me bashkëpartiakët e tij, mbrëmë, në terr, ka marrë një vendim të padinjtitshëm dhe antikombëtar dhe të cilat shkojnë në linjë me fabrikimet kundër UÇK-së. PDK do të jetë

konsistente për ta ndaluar këtë qasje antikombëtare të kësaj qeverie e cila koordinohet me Radojçiqin për marrjen e vendimeve në dëm të interesave të qytetarëve dhe shtetit të Kosovës", ka përfunduar deputetja Deliu-Kodra.

Në anën tjetër, koordinatori i Departamentit për Financa në kuadër të KQM-së, Arben Mustafa, e ka quajtur vendim tjetër skandaloz të qeverisë së Albin Kurtit përjashtimin e veteranëve nga rritja sado e vogël e pagës minimale.

Një ditë më parë, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se kjo qeveri nuk ka më asnjë lloj kredibiliteti për ta qeverisur vendin. "Mandati duhet t'u kthehet qytetarëve sa më parë. Kosova ka nevojë për zgjedhje të reja që sjellin një qeveri ndryshe - të përgjegjshme e të besueshme dhe që e rikthen rrugëtimin e vendit në kursin e integritetit euroatlantik dhe prosperëndimor!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Të premtën për zhvillimet në vend ka reaguar edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se qeveria Kurti "po na

ngul thikë pas shpine aty ku na dhemb më së shumti". "Zbardhja e koordinimit të fshehtë të përfaqësuesve të Albin Kurtit me armiqtë e shtetit të Kosovës, për ta përmbysur kategorinë më të shenjtë - luftëtarët e lirisë, është thikë pas shpine. Thikë pas shpine është edhe prishja e marrëdhënieve me aleatët e Kosovës, BE-në dhe ShBA-në, që rezultoi me përjashtimin e Kosovës nga 'Defender 23', duke e komplikuar tej mase aspiratën e Kosovës për anëtarësim në strukturat euroatlantike", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka thënë se tërheqja e Kurtit nga veriu, me një vonesë të pashpjegueshme dhe vetëm pasi që Kosova është futur nën sanksione të BE-së dhe të ShBA-së, duke i shkaktuar kështu një dëm të pariparueshëm vendit, nuk mund të konsiderohet ndryshe përveç si një politikë antishtetërore e antikombëtare. "Ngjarjet e djeshme në Kuvendin e Kosovës dhe dhuna e shpërfaqur aty, janë alarm se situata mund të përshkallëzohet jo vetëm në Kuvendin e Kosovës, por edhe jashtë tij. Kosova nuk mund të

BE-ja pret hapa të tjerë nga Kosova për t'i hequr masat

PRISHTINË, 14 KORRIK - Heqja e masave ndëshkuese që Bashkimi Evropian i ka vendosur Kosovës do të varet nga zbatimi i obligimeve që ka marrë Prishtina dhe hapat e tjerë që priten nga autoritetet në Kosovë për vazhdimin e përpjekjeve për t'i ulur tensionet në veri, thanë burimet diplomatike. Sipas këtyre burimeve, këto hapa që po ndërmerr Kosova "janë hapa në drejtim të duhur", por në BE presin të shohin edhe hapa të tjerë. "Masat ndaj Kosovës nuk ishin vendosur aq lehtë, ato janë të kthyeshme dhe nuk do të zgjasin asnjë ditë më shumë sesa duhet. Por, për tërheqjen e tyre duhet dëshmi se Kosova po i ndërmerr të gjitha hapat që janë kërkuar nga ajo dhe për shkak të të cilave edhe ishin vendosur këto masa", tha një burim në BE për Radion

Evropa e Lirë. Për shkak të mospërbushjes së kërkesave të paraqitura nga blloku evropian, Brukseli në fund të qershorit nisi t'i zbatonte disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës. Masat që po zbaton BE-ja ndaj Kosovës përfshijnë: pezullimin e përkohshëm të punës së trupave të krijuara në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), mosftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë dhe pezullimin e vizitave dypalëshe, përveç atyre që përqendrohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja. Masat e tjera përfshijnë edhe ndaljen e programimit të fondeve për Kosovën nga IPA 2024 (Instrumentet e Para-Anëtarësimit) si dhe propozimet e Kosovës në kuadër të Kornizës së

Investimeve në Ballkanin Perëndimor nuk janë dorëzuar për shqyrtim nga bordi më 29 dhe 30 qershor. Megjithatë, më 10 korrik Kosova dhe BE-ja kanë arritur pajtim për hapat e parë drejt shtensionimit të situatës në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. As në BE nuk i janë përgjigjur drejtpërdrejt pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse pajtimi i arritur me Kosovën për shtensionimin e situatës në veri të shtetit do të çojë në heqjen e masave ndëshkuese që Brukseli ka vendosur ndaj Prishtinës. Një zëdhënës i BE-së tha për REL-in se "nuk kemi asgjë për të shtuar asaj që përmes një postimi në 'Twitter' ka thënë përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, kur mirëpriti përkushtimin e Kosovës dhe pret nga Kosova hapa të tjerë

pozitivë për ta vazhduar avancimin në këtë drejtim". Borrell deklaroi më 12 korrik se do të vazhdojë puna me Kosovën dhe Serbinë në kuadër të dialogut për normalizimin e raporteve. "Procesi po vazhdon", tha zëdhënësi, duke kujtuar se i dërguari i posaçëm i BE-së për dialog, Miroslav Lajçak, dhe zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, janë pajtuar për hapat e parë prioritarë në tri fusha që kishin kërkuar BE-ja. "Kjo përfshin zvogëlimin e menjëhershëm të pranisë së policisë në dhe rreth ndërtesave të komunave, kryerje të vlerësimeve të rregullta të përbashkëta të sigurisë me EULEX-in dhe KFOR-in sipas nevojës, të shqyrtohet mundësia për zvogëlim të mëtejme të pranisë, të mos bëhet asnjë lëvizje që mund ta

përkallëzohet situatën dhe të inkurajohen zgjedhjet e jashtëzakonshme, sikur edhe krijimi i bazës ligjore për zgjedhje", tha zëdhënësi. Ai, po ashtu, konfirmoi se Lajçaku ka ftuar në takim javën e ardhshme kryenegociatorët e Kosovës dhe Serbisë për t'i vazhduar diskutimet për zbatimin e Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve. "Presim që palët të pajtohen për hapat e radhës të cilët do të mundësojnë nisjen e zbatimit të plotë të marrëveshjes, pa vonesa të reja", tha zëdhënësi. Tensionet në veri u rritën në fund të majit, kur kryetarët e rinj shqiptarë në veri, nën përcjelljen e policisë, hynë në ndërtesat komunale. Serbët në veri kanë protestuar duke kërkuar tërheqjen e kryetarëve dhe njësi speciale të Policisë së Kosovës.



qëndrojnë e qetë në kohën kur qeveria e vendit na e ngulë thikën pas shpine aty ku na dhemb më së shumti, në lidhjen më të shenjtë të Kosovës, me NATO-n, Amerikën dhe me kategoritë e lirisë. Do të jemi të pakompromis dhe më të vendosur se kurrë në mbrojtje të interesave të shtetit e të

qytetarit, aspiratës sonë për anëtarësim në NATO, në ruajtjen e miqësisë me aleatët tanë, Amerikën dhe BE-në e në mbrojtje të vlerave të lirisë sonë", ka thënë Haradinaj. Për ngjarjet e fundit në vend ka reaguar edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, i cili ka thënë se ngjarja në Kuvendin e

Kosovës ishte një episod i errët i historisë parlamentare në vend. "Në një kohë kritike për Republikën dhe të ardhmen tonë si shtet. Dhuna nuk është mjet. Nuk ishte as sot e nuk ishte as dje. Dhuna në Kuvendin e Kosovës është shëmti. Ajo shpërfaqet vetë demokracinë dhe kulturën politike për të

cilën kemi nevojë si shoqëri. LDK-ja e refuzon këtë qasje si mjet. Siç dhe refuzon gjuhën polarizuese, përçarëse e nxitëse që është bërë tashmë standard i sjelljes së pushtetit. Dhe jemi krenarë për këtë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook". Ai ka thënë se duket se rruga e Kosovës është e humbur

tashmë. "Vendi ynë ka nevojë për një rrugë të re, të tretë. Një që na bën vend normal, zhvillimor e euroatlantik. Ky vend, ky shtet, kjo shoqëri, ka nevojë për zgjim kolektiv dhe vendosje të binarëve euroatlantikë. Ju ftoj në këtë rrugëtim!", ka deklaruar Abdixhiku.

Fillojnë punimet për ndërtimin e aneksit të shkollës "Pavarësia"

PRISHTINË, 14 KORRIK - Nën kryetarja e komunës së Prishtinës, Donjeta Sahatçiu, ka bërë me dije se kanë filluar punimet për ndërtimin e aneksit të shkollës "Pavarësia" në rrugën "Muharrem Fejza". "Me 12 klasa të reja dhe tri kabinete me aneksin e ri, kjo

shkollë, e vetmja aktualisht në kryeqytet, nuk do ta ketë më të nevojshme të punojë në tri ndërrime shkaku i mbingarkesës me nxënës. Siç e kemi thënë në takimet me banorët e lagjes, ky aneks i shumëpritur ka qenë prioriteti ynë nga fillimi.

Shumë e lumtur që me Besianën dhe ekipin e saj në Drejtorinë e Arsimit do t'i përcjellim sa më afër punimet ashtu që nxënësit ta gëzojnë hapësirën e re jo më larg se 250 ditë të punimeve me kontratë", ka theksuar Sahatçiu.



IKShPK-ja jep dhjetë rekomandime për kujdes nga temperaturat e larta

PRISHTINË, 14 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se temperaturat e larta që mbretërojnë në sezonin e verës ndikojnë negativisht në organizmin e njeriut, sidomos të të moshuarit. Duke u ekspozuar në diell për një kohë të gjatë mund të pësojmë goditje nga të nxehtët që çon në dehidrim të organizmit, përcjell me ngërçe, vjellje, çrregullime diarreike, skuqje dhe djegie të lëkurës, duke komplikuar sistemin kardiovaskular deri në insuficiencë renale.

IKShPK-ja ka dalë me dhjetë rekomandime mbrojtëse për shëndetin e personave të moshuar gjatë ekspozimit ndaj temperaturave të larta të ajrit mbi 30°C, posaçërisht për të moshuarit me sëmundje kardiovaskulare dhe sëmundje të tjera kronike. "1. Personat e moshuar asses nuk duhet të ekspozohen në rrezet e diellit në intervalin kohor prej orës 10.00-17.00, sidomos jo të moshuarit me sëmundje të zemrës ose ata me diabet; 2. Gjatë daljes nga shtëpia të moshuarit detyrimisht duhet ta mbrojnë kokën me



kapelë ose shall; rrobat duhet të jenë të holla, komode, prej liri ose pambuku dhe me ngjyra të çelëta; 3. Është e domosdoshme marrja e 2 litrave lëngje gjatë ditës, qoftë si 8 gota ujë ose në formë supe ose qaji; po ashtu duhet anashkaluar ushqimin e fërguar, shumë të njelmët ose të ëmbël ose me mëlmesa të

shumta, ndërsa duhet marrë shumë pemë dhe perime sezonale; 4. Përveç këshillave të marra nga mjeku për përdorimin e barnave, tek të moshuarit është e domosdoshme matja më e shpeshtë e tensionit arterial; 5. Paraqitja e kokëdhembjes, mundimit, marramendjes dhe dehidrimit, tharjes së gojës dhe

lëkurës, janë shenja alarmante për të moshuarin, sidomos kur është i sëmurë dhe ka paaftësi funksionale; atëherë doemos i sëmuri geriatrik duhet të lajmërohet tek mjeku i tij familjar ose në qendrën më të afërt emergjente; 6. Anëtarët e familjes, miqtë, fqinjët dhe anëtarët e OJQ-ve të cilët

kujdesen për të moshuarit gjatë muajve të nxehtë të verës duhet doemos më shpesh të kontaktojnë me të moshuarit, e në raste të paaftësive funksionale edhe disa herë gjatë ditës; 7. Në rast se del jashtë shtëpisë/banesës ku jeton, i moshuari duhet detyrimisht të bartë me vete të dhënat elementare, emrin dhe mbiemrin, vitin e lindjes, adresën e banimit, numrin e telefonit të personit kontaktues, i cili mund të kontaktohet lidhur me këtë person të moshuar; 8. Më e rëndësishmja është mirëmbajtja e higjienës personale dhe asaj të ambientit të të moshuarit, si dhe mbikëqyrja e përdorimit të barnave në mënyrë të rregullt; 9. Është i domosdoshëm aktiviteti fizik dhe psikik i të moshuarit, sidomos ecja e vazhdueshme në orët e para të mëngjesit ose në mbrëmje, qëndrimi sa më i gjatë në natyrë (park, shëtitore etj). 10. Nëse i moshuari ka vështirësi për të lëvizur për shkak të pamjaftueshmërive funksionale, atëherë duhet bërë ajrosjen shumëorëshe të hapësirave ku qëndron i moshuari", theksohet në rekomandimet e IKShPK-së.

Fillon zyrtarisht fushata e korrje-shirjeve në Malishevë



Malishevë, 14 korrik - Ka filluar zyrtarisht të premtën fushata e korrje-shirjeve në komunën e Malishevës.

Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Sylë Dukolli, ka bërë me dije se është formuar shtabi komunal për korrje-shirje dhe janë bërë të gjitha përgatitjet për një mbarëvajtje sa më të mirë. "Besojmë në përfundim brenda

afatit kohor të korrje-shirjeve në komunën tonë pasi edhe kushtet klimatike do të jenë në favorin e bujqve", ka thënë Dukolli. Shtabi komunal për korrje-shirje ka përgatitur planin operativ dhe do të punojë sipas rregullores për korrje-shirje. Aty parashihet edhe çmimi për hektar të cilin e ka rekomanduar MBPZhR-ja prej 130 eurosh. "Nga terreni informohemi se rendimentet e

grurit variojnë nga 2 000 kg për ha deri në 3000 kg. Pra, edhe këtë vit kushtet klimatike ndikuan dukshëm në uljen e rendimentit të grurit jo aq kënaqshëm sa ishin pritjet. Nëse mbretëron koha me mot të mirë, fushata e korrje-shirjeve në komunën e Malishevës pritet të përfundojë brenda afatit prej dy javësh të paraparë sipas shtabit komunal për korrje-shirje", ka thënë Dukolli.

Bulliqi inspekton punimet në Stacionin e Autobusëve

PODUJEVË, 14 KORRIK - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi dhe drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi, i kanë përcjellë nga afër punimet që po zhvillohen në ndërtimin e Stacionit të ri të Autobusëve në qytetin e Podujevës.

Kryetari Bulliqi gjatë kësaj vizite tha se projekti i Stacionit të Autobusëve po zhvillohet sipas planit dinamik. "Presim që gjatë fillimit të vitit të ardhshëm të përfundojë si projekt, i cili do të bëjë edhe organizim më të mirë të komunikacionit, si dhe do t'i përmirësojë linjat e

qarkullimit të autobusëve në fshatrat dhe qytetet e tjera", ka thënë Bulliqi. Projekti i Stacionit të Autobusëve në Podujevë po realizohet në bashkëfinansim në mes të komunës së Podujevës, Ministrisë së Zhvillimit Rajonal dhe Ministrisë së Infrastrukturës.



Nënshkruhet memorandumi për renovimin e Sallës së Kuqe në Pallatin e Rinisë

Prishtinë, 14 korrik - Salla e Kuqe në Pallatin e Rinisë shumë shpejt do të rinovohet. Kryeshefja e këtij institucioni, Mrika Gashi-Macula, ka nënshkruar memorandumin bashkëpunues së bashku me kryeshefin e Ndërmarrjes Publike Banesore, Artan Berisha, për rinovimin e sallës. Mrika Gashi-Macula ka theksuar domosdoshmërinë

për rinovimin e kësaj salle, e cila, sipas saj, është e vetmja adresë për artistët për t'i zhvilluar aktivitetet e tyre. "Ka qenë një nga vendimet e para që kam marrë sapo kam ardhur në krye të NPL Pallatit të Rinisë. Është emergjente t'i japim kësaj salle pamjen dinjitoze dhe jam e lumtur që kësaj nisme iu ka bashkangjitur menjëherë dhe

z. Artan Berisha, sepse në këtë mënyrë u ofrojmë qytetarëve dhe artistëve tanë kushte adekuate dhe një standard në salla koncertale si kjo", ka thënë ajo.

Ndërsa Artan Berisha u shpreh i gatshëm dhe bashkëpunues për ta dhënë kontributin e tij duke i krijuar kushtet adekuate për këtë sallë dhe projekte të tjera.



Kosovës i shtohen edhe 419 policë të rinj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 KORRIK - Në Sallën 1 Tetori në Prishtinë është mbajtur të premtën ceremonia e diplomimit të gjeneratës së 58-të të Policisë së Kosovës. Në këtë ceremoni morën pjesë personalitetet më të larta shtetërore, përfshirë përfaqësues nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, eprorë të Policisë së Kosovës dhe familjarë të zyrtarëve policorë që diplomuan. "Policia e Kosovës vazhdon të jetë një ndër institucionet më të besueshme

për qytetarët tanë. Vazhdon ta zbatojë me sukses misionin kushtetues që ta mbrojë jetën dhe pronën e qytetarëve, ta mbajë rendin dhe qetësinë publike, ta parandalojë dhe zbulojë krimin, t'i mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut e t'i trajtojë në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët pa dallim etnie, religjioni, gjinie a moshe", kështu ka thënë kryeministri Albin Kurti në ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së 58 të Policisë së Kosovës.

Para të pranishmeve të shumtë, përfaqësues të institucioneve e familjarë të policëve të

sapodiplomuar, kryeministri tha se është i lumtur që ndodhet në këtë ngjarje të rëndësishme për Policinë e Kosovës, në të cilën diplomuan 418 kadetë, në përbërje gati të të gjitha komuniteteve që jetojnë në republikën tonë. Ai ka theksuar se që nga marrja e mandatit të qeverisë janë zotuar për luftë të pakompromis ndaj korrupsionit, veçanërisht atij që është mirëmbajtur me vite në institucionet tona, për luftim ndaj çdo lloj krimi të organizuar që, mbi të gjitha, ka rënduar mirëqenien e qytetarëve tanë. "Për ruajtje të sovranitetit dhe

integritetit territorial të Republikës sonë. Policia jonë, për këto dy vjet, ka qenë maksimalisht e angazhuar për realizimin e këtyre prioriteteve të përbashkëta", u shpreh kryeministri Kurti.

Edhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, tha se sulmet ndaj zyrtarëve të Policisë së Kosovës janë shtuar dhe tha se ata po përballen me "banda kriminale" në veri të vendit.

Në ceremoninë e diplomimit të gjeneratës së 58 të Policisë së Kosovës, ku diplomuan 419 kadetë të rinj, mori pjesë edhe presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani. "Sot, të gjithë së bashku, të shprehim edhe një herë falënderimin dhe krenarinë tonë të pashoqe me policët e policet tona që po shërbejnë në veriun e vendit tonë për ta mbrojtur çdo pëllëmbë të Republikës së Kosovës", ka thënë Osmani. Ajo bëri thirrje për anëtarësimin e Kosovës në Agjencinë Ndërkombëtare Policore (Interpol) dhe Agjencinë Evropiane të Policisë (Europol). Osmani u shpreh e lumtur që në mesin e kadetëve të rinj ka edhe pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, gjithsej 85, dhe vajza e gra, gjithsej 47.

Drejtori i ShSKUK-së viziton Klinikën Obstetrike Gjinekologjike

PRISHTINË, 14 KORRIK - Drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK), Elvir Azizi, ka vizituar Klinikën Obstetrike Gjinekologjike. Ai ka

parë punën që po bëhet për rinovimin e disa reparteve dhe krijimin e shërbimeve të reja shëndetësore.

Zef Ndrejaj, drejtor i Klinikës së Gjinekologjisë, bashkë me disa

nga shefat e reparteve, e njoftoi drejtorin se po bëhet punë e mirë për rinovimin e disa reparteve, krahas punës për zgjerimin e shërbimeve të reja që pritet të nisnin në të ardhmen.



Kurti inspektoi punimet në zgjerimin e rrugës Prishtinë - Podujevë

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga zëvendësministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka vizituar punimet që janë duke u zhvilluar në zgjerimin e rrugës nacionale Prishtinë - Podujevë. Me këtë rast, kryeministri Kurti i falënderoi punëtorët e inxhinierët për punën e tyre të pandalshme ditë e natë, për ta përfunduar në afatin sa më të shpejtë kohor këtë rrugë. Në fillim të javës, në ndërtesën

e qeverisë, kryeministri kishte mirëpritur për një tryezë diskutimi pronarët e kompanive të ndërtimit të rrugëve, njëherësh operatorë ekonomikë të kontraktuar në projektet aktuale infrastrukture. Në atë takim kryeministri Kurti i kishte ftuar ata t'i shtojnë kapacitetet e angazhuara në pajisje dhe personel për realizimin e obligimeve të kontraktuara, t'i respektojnë maksimalisht standardet, kualitetin/cilësinë e materialeve dhe sigurinë në punë, ta mundësojnë

qarkullimin e automjeteve nëpër segmentet ku punohet në veçanti në periudhën e vizitës së bashkatdhetarëve dhe në segmentet me qarkullim të madh, të shfrytëzohet edhe nata për t'i ekzekutuar punët. Gjithashtu, kishte shprehur gatishmërinë t'i vizitojë punët të cilat kryhen edhe gjatë natës në stinën e verës. Kjo rrugë, e cila po zgjerohet, ka një gjatësi të gjithëmbarshme rreth 15 km në lote të ndryshme dhe kap vlerën rreth 35 milionë euro.



Paga minimale rritet në 264 euro, përjashtohen veteranët e UÇK-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 KORRIK - Një ditë më parë Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të rregullt plenare, në të cilën ka miratuar disa projektligje. Në mesin e tyre në lexim të dytë Projektligjin për Pagën Minimale, që parashikon që kjo pagë të rritet në 264 euro bruto. Për këtë projektligj kanë votuar 60 deputetë dhe një ka abstenuar. Seanca është bojkotuar nga partitë opozitare.

Për të hyrë në fuqi, projektligji, pas miratimit në Kuvend, duhet të nënshkruhet nga presidentja e vendit. Paga minimale në Kosovë sillet nga 130 deri në 170 euro. Kjo vlerë, e pandryshuar që nga viti 2011, është më e ulëta në Evropë, sipas Agjencisë Evropiane të Statistikave - Eurostat.

Projektligji që kaloi në lexim të dytë nuk parasheh lidhjen e pagës minimale me pensionin që marrin veteranët e luftës. Kjo nënkupton që veteranët do të vazhdojnë të marrin pension në vlerë prej 170 eurosh. Për këtë gjë ata kanë protestuar disa herë.

Pas votimit në Kuvend, ushtruesi i detyrës i Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Faton Klinaku, ka kritikuar këtë vendim të deputetëve. "Siç po marr vesh nga mediet, pasi u largua opozita nga salla, në terr, deputetët e këtij pushteti të paskrupullt, e kanë kaluar Ligjin për Pagën Minimale, duke i hequr prej tij veteranët e luftës së UÇK-së. Ne do të takohemi si organe drejtuese



dhe do të vendosim për hapat që do t'i ndërmarrim", ka shkruar ai në "Facebook". Në Kosovë mbi 80 mijë të punësuar në sektorin publik marrin pagë mesatare bruto 604 euro, ndërsa paga mesatare bruto në sektorin privat është 473 euro. Kuvendi në këtë seancë ka miratuar në shqyrtim të dytë këto projektligje: Projektligjin nr. 08/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118; Projektligjin nr. 08/L-199 për ndryshimin dhe plotësimin

e Ligjit nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore; Projektligjin nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera Gjatë Luftës në Kosovë; Projektligjin nr. 08/L-191 për Ekspertët Gjyqësor; Projektligjin nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar; Projektligjin nr. 08/L-200 për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjithëse, si dhe Projektligjin nr. 08/L-201 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-081 për Energjinë. Më tutje, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, paraqiti dhe arsyetoi Projektligjin nr. 08/L-227 për Përfaqësimin e

Institucioneve Shtetërore në Procedura Gjyqësore dhe Arbitrazh, i cili më pas u miratua me shumicë votash. Edhe Projektligji nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, i cili u prezantua dhe u arsyetua nga ministri Hajrullah Çeku, i deleguar nga ministri i linjës, u miratua me shumicë votash. Në emër të qeverisë, ministrja Artane Rizvanolli paraqiti dhe prezantoi Projektligjin nr. 08/L-238 për Fondin sovran të Republikës së Kosovës, duke theksuar se ky projektligj rregullon mënyrën e qeverisjes së fondit me pavarësi

funkionale, operacionale dhe funksionale, si dhe vendos rregullat për menaxhimin e aseteve për investime dhe mënyrën e financimit të fondit. Ky projektligj u miratua me 61 vota.

Kuvendi në vazhdim e miratoi raportin me rekomandim për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, si dhe raportin me rekomandime për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit dhe të Ligjit nr. 08/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit.

Këngëtarët për gjashtë muaj paguan tatim 1.2 milion euro

Prishtinë, 14 korrik - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se qarkullimi i deklaruar për vitin 2021 ishte 10.7

milionë euro, kurse në vitin 2022 është 20.9 milionë euro, ndërsa tatimet e paguara nga këngëtarët dhe grupet muzikore për

vitin 2022 janë mbi 2 milionë euro që, në krahasim me vitin e kaluar, ka rritje të deklarimit dhe pagesave mbi 100 %.

"Vetëm në periudhën janar-qershor 2023 pagesat e tatimeve nga këngëtarët janë 1.2 milion euro", ka njoftuar ATK-ja.



Zbulimi që mund të zhdukë njëherë e mirë krizat energjetike



Super-përçuesit janë materiale që nuk ofrojnë rezistencë ndaj kalimit të energjisë elektrike. Ato lejojnë që rryma të transportohet pa asnjë shpërndarje në formën e nxehtësisë apo dritës. Por ka një problem që e kufizon ndjeshëm mundësitë e tyre të përdorimit: që të shfaqin cilësitë e tyre duhet t'i nënshtrohen temperaturave shumë të ulëta ose presioneve shumë të larta. Prandaj, funksionimi i tyre në temperaturën e mjedisit, është një nga ëndrrat e vjetra të fizikës moderne. Por është pikërisht ajo që besojnë se kanë zbuluar studiuesit në laboratorët e Universitetit të Roçesterit. Lutetium hidrit, një material i ri tregon karakteristikat e super-përcjellshmërisë në një temperaturë prej vetëm 21 gradë Celcius, dhe në kushte presioni jo shumë të larta. Zbulimi, i prezantuar pak ditë më parë gjatë kongresit vjetor të Shoqatës Amerikane të Fizikës, u prit me

një entuziazëm nga komuniteti shkencor. Dhe arsyeja është e lehtë për t'u kuptuar: një super-përçues që punon në temperaturë normale, do të ishte një zbulim vërtet revolucionar, me pasoja në një mori fushash të teknologjisë. Për shembull, do t'i bënte më pak të kushtueshme pajisjet ku përdoren tashmë super-përçuesit për të krijuar mbështjellje magnetike, si në skanerët MRI. Dhe kjo do t'i hapte derën zbatimeve krejtësisht të reja, si trenave të lirë që lëvizin përmes fushës magnetike, dhe që do të jenë të aftë të udhëtojnë në distanca të krahasueshme me ato të avionëve, apo bateritë me kohë rimbushjeje shumë të shpejta, që do jenë të afta të ruajnë përgjithmonë ngarkesën e tyre. Por mbi të gjitha, do ta revolucionarizonte mënyrën se si e prodhojmë dhe

transportojmë energjinë. Mund të duket e parëndësishme, por fakti që kabllo të bakrit e humbasin energjinë elektrike në formën e nxehtësisë, i kufizon shumë vendet ku mund të prodhohet ajo. Sepse me distancën që duhet të përshkojë energjia elektrike, humbet jo pak sasi gjatë rrugës. Me kabllo elektrike me materiale super-përçuese, do të kursehej jo vetëm energjia elektrike që aktualisht humbet gjatë transportit, por mund të mos jetë më nevoja e zhvendosjes së impianteve të prodhimit. Po ashtu do të kishte një zhvillim akoma më të madh të energjive të rinovueshme. Për shembull, imagjinoni se si do të ishte bota nëse do të mund të mbulonim qendrën e shkretëtirës së Saharasë me panele diellore, dhe më pas ta transportonim në të katër anët e globit energjinë e prodhuar atje.

Apo ndërtimin e termocentrale bërthamore në zona krejtësisht të pabanuara për të kufizuar rreziqet. Apo shfrytëzimin e termocentraleve gjeotermale apo me erë në zona të largëta, duke kufizuar ndikimin e tyre në peizazh. Dhe për ta bërë këtë, duhet një super-përçues i aftë të punojë temperatura dhe presion jo ekstrem. Ato që disponohen aktualisht punojnë në temperaturat -160 dhe -140 gradë Celcius. Prandaj, kanë nevojë për sisteme të mëdha ftohje. Materiali i përshkruar nga studiuesit në Universitetin e Roçesterit, tregonte se super-përcjellësi mund të punojë në temperaturën 21 gradë dhe me një presion 10 kilobar, ose rreth 10 herë më i lartë se ai i përjetuar në thellësitë të mëdha të oqeanit, por gjithsesi shumë më i ulët sesa miliona ATM (atmosfer, njësi e matjes së presionit) që janë të nevojshme për të

prodhuar materiale të tjera me tipare të ngjashme super-përçuese. Materiali në fjalë u përftua nga një përzierje e hidrogjenit, azotit dhe lutetiumit (një mineral irralë), dhe në eksperimentet e kryera ai tregoi të gjitha karakteristikat tipike të një super-përçuesi: jo vetëm rezistencë elektrike zero, por edhe fushë magnetike të fortë si dhe një ndryshim drastik në kapacitetin e nxehtësisë. Për autorët e studimit, kjo është një provë e pagabueshme: materiali i ri është super-përçuesi i parë i zbuluar ndonjëherë, i aftë të veprojë në temperatura që janë normale për ne. Me kujdesin e duhur, mund të zgjidhen pa shumë probleme edhe kriteret e presionit. Nëse ndodh kjo, materiali i ri mund të përdoret relativisht së shpejti.



Shabani: Dukagjini kualifikohet në raundin tjetër

Autori i golit të parë historik për Dukagjinin në ndeshjen evropiane, Bujar Shabani, për “Epokën e re” ka thënë se skuadra nga Klina ka potencial për t’u kualifikuar në raundin tjetër të Ligës së Konferencës. “Me rëndësi është se e fituam ndeshjen e parë dhe tash duhet të përgatitemi dhe të përqendrohemi për ndeshjen kthyesë që nuk do të jetë aspak e lehtë. Megjithatë, jam i bindur se do të kalojmë tutje në garën e Ligës së Konferencës, gjithmonë duke u bazuar në kualitetin që kemi si ekip”, ka deklaruar Shabani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Dukagjini i Klinës debutoi në mënyrën më të mirë në garat evropiane, duke shënuar fitore ndaj FC Europa (2-1) në ndeshjen e rrethit të parë kualifikues të Ligës së Konferencës në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”. Golin e parë historik për klubin nga Klina e shënoi mesfushori me përvojë të madhe, Bujar Shabani, i cili të premten për “Epokën e re” ka thënë se cilësia e Dukagjinit është më e madhe se e kundërshtarit, por presioni i ndeshjes së parë ndërkombëtare e bëri të vetën. “Një fitore shumë e ëmbël për ekipin tonë dhe qytetin e Klinës që u paraqitëm për herë të parë në garat evropiane. Pa modesti mendoj se jemi në nivel më të lartë se kundërshtari, por ndeshja e parë në këtë kompeticion na vuri në presion. Për fitore kanë meritë të madhe tifozët ‘Hithat’ që gjithmonë janë pranë nesh dhe të gjithë qytetarët e Klinës”, ka thënë Shabani. Mesfushori me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës realizoi gol në minutën e 30. Ai është shprehur i bindur se skuadra nga Rrafshi i Dukagjinit do të kualifikohet më tutje në Ligën e Konferencës. “Me rëndësi është se e fituam ndeshjen e parë dhe tash duhet të përgatitemi



dhe të përqendrohemi për ndeshjen kthyesë që nuk do të jetë aspak e lehtë. Megjithatë, jam i bindur se do të kalojmë tutje në garën e Ligës së Konferencës, gjithmonë duke u bazuar në kualitetin që kemi si ekip”, ka deklaruar Shabani. Presidenti i skuadrës së Dukagjinit, Fabian Veseli, i kënaqur me fitoren historike të skuadrës, i ka falënderuar të gjithë ata që kontribuon në këtë fitore. “Klinë, faleminderit shumë! Ndeshje historike për qytetin. Faleminderit për përkrahjen e vazhdueshme! Respekt dhe faleminderit stafit të trajnerëve dhe futbollistët për angazhimin! ‘Hithat’, respekt dhe

faleminderit për kulturën!”, ka shkruar Veseli. Ndërsa trajner Armend Dallku pas ndeshjes është shprehur paksa i zhgënjyer për faktin se skuadra që ai drejton ka pasur mundësi të shënojë më shumë gola. “Nëse them se jam i kënaqur gënjej. Nuk jam i kënaqur. Kishim shumë mundësi për ta thelluar rezultatin. Në momentin kur nuk duhej, pranuar gol. Ne jemi më lart se kundërshtari, por disa lojtarë nuk ishin në elementin e tyre. I uroj të gjithë adhuruesit e Dukagjinit dhe të gjithë Kosovës për këtë fitore”, ka thënë Dallku. Dukagjini ndeshjen kthyesë e zhvillon pas një jave në Gjibraltar.

SHKURT

Arteta: Xhaka mendoi se tani ishte koha e duhur për t’u larguar

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka folur për largimin e mesfushorit Granit Xhaka. Mesfushori shqiptar ka luajtur shtatë vjet për klubin anglez, kurse në fillim të këtij muaji vendosi t’i bashkohet Bayer Leverkuseni. “Ai e kishte të qartë se tani është koha e duhur për një hap të tillë. Ai gjeti mundësinë për t’u transferuar te Leverkuseni. Ne e diskutuam këtë dhe në fund të gjitha palët ranë dakord që ky ishte vendimi i duhur”, ka thënë Arteta. Xhaka u paraqit 297 herë për Arsenalin dhe shënoi 23 gola.

Serbia nuk shfaqet në fushë, Kosova U22 fiton në tavolinë

Kosova U22 femrat ka fituar pikë në tavolinë në Kampionatin Ballkanik të Beach Volley në përballjen kundër Serbisë. Në fakt, Serbia nuk u paraqit në fushë, andaj kjo nënkuptoi që vashat “dardane” (Yllka Jashari/Melirona Avdullahu), të drejtuara nga Vildane Jashari, fituan pikët e para në këtë Kampionat Ballkanik, i cili është duke u mbajtur në Maqedoninë e Veriut.

Rashica refuzon Fenerbahçen: Në Turqi luaj vetëm për Galatasarayn

Milot Rashica raportohet se e ka refuzuar gjigantin turk Fenerbahçe. Sipas medias turke, Ajans 1905, ylli i Kosovës ka refuzuar ofertën e Fenerbahçes. “Në Turqi luaj vetëm për Galatasarayn”, raportohet të ketë qenë përgjigja e anësorit. Në edicionin e kaluar Rashica ishte pjesë e Galatasarayt, duke e fituar titullin e kampionit. Ai ishte i huazuar nga Norwich, ndërsa nuk dihet se ku do të luajë në sezonin e ardhshëm.

Augsburgu: Asnjë ofertë konkrete nuk e kemi për Berishën

Drejtori sportiv i Augsburgut, Stefan Reuter, ka bërë me dije se ende nuk kanë marrë asnjë ofertë konkrete për Mërgim Berishën. Sulmuesi u ble nga klubi i Bundesligës pak javë më parë nga Fenerbahçe për 4 milionë euro, ndërsa e kaloi sezonin e fundit në formë huazimi nga Fenerbahçe. “Ne ishim të qartë kur diskutuam me lojtarin, me të cilin erdhëm në përfundim se do të flasim nëse ai vjen te ne me dëshirën që ta ndërrojë ekipin dhe nëse ka oferta konkrete. Për momentin nuk ka kërkesa konkrete, kështu që Mërgim Berisha do të rikthehet për të ushtruar pas kampit stërvitor, kur të kompletohet rehabilitimi i tij”, ka deklaruar Reuter për “Augsburger Allgemeine”. Augsburgu i kërkoi 20 milionë euro që ta lë Berishën të largohet gjatë kësaj vere. Futbollisti nga Suhareka mund të transferohet në Werder Bremen si zëvendësues i Niclas Fullkrug, nëse ky i fundit do të largohet nga klubi gjelbër e bardhë.

Marigona Hajdari transferohet te Silkeborgu

Prishtinë, 14 korrik - Organizatorja e lojës së Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Marigona Hajdari, ka bërë hap të rëndësishëm në karrierë. Marigona të premten është zyrtarizuar te skuadra Silkeborg-Voel, që garon në elitën e Danimarkës. 23-vjeçarja deri më tani ishte te Ringkobingu që, po ashtu, luan në elitën e Danimarkës. Por Silkeborgu është skuadër

më e madhe, që vazhdimisht paraqitet në plejofin e Superligës daneze. Marigona për gjashtë vjet kishte luajtur për Ringkobingun dhe vendosi të provojë diçka të re në karrierë. “Silkeborg-Voel është klub atraktiv me shumë vjet në plejofin e ligës daneze. Kjo tregon mjaft për nivelin dhe ambiciet e klubit. Për më tepër, mua gjithnjë më ka pëlqyer stili i lojës së

Silkeborg-Voel dhe mendoj se më përshtatet. Mezi po pres të bashkohem me ekipin, t’i takoj vajzat dhe njerëzit në klub”, ka thënë Marigona Hajdari. Ajo ka kohë që është prej lidereve në Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll. Shquhet për organizimin shembullor të lojës, asistimet dhe shpërthimet në zonën e kundërshtarit.



Mick Schumacheri piloton në 'Goodwood' me kokoren e babait

Stuttgart, 14 korrik - Piloti gjerman Mick Schumacher, që këtë sezon është pilot rezervë në Mercedes në Formula 1, këtë fundjavë do të marrë pjesë në një turne që zhvillohet në "Goodwood". Në këtë turne

Mick ka vendosur të garojë me kokoren që babai i tij Michael Schumacher ka përdorur në botërorin 2011. Duket se Mick Schumacher është disi nostalgjik për atë periudhë, ndaj ka vendosur ta mbajë kokoren që babai i

tij mbante kur pilotonte makinën Mercedesin. Ishte pikërisht makina gjermane ajo që konfirmoi këtë lajm, duke postuar edhe foton e pilotit të ri gjerman. Një foto mjaft e bukur, pasi duket sikur vërtet se në atë kokore

është Michael Schumacheri, 7 herë kampioni i botës në Formula 1. Sytë e Mick në atë kokore sjellin kujtime të bukura për fansat e Formulës 1. Me atë kokore Mick arriti një vend të katërt në Kanada.



Kosova mposht Lihtenshtajnin me rezultat të thellë

PRISHTINË, 14 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll për femra e ka mposhtur Lihtenshtajnin me rezultat bindës 4-0 në ndeshjen e parë miqësore që është zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali.

Trajnerja Anneli Andersen hodhi në fushë formacionin me këtë përbërje: Besarta Leci, Rrezona Ramadani, Valentina Limani, Lumbardha Misini, Albulena Guri, Erëleta Memeti, Merita Bajrami, Feride Kastrati, Kaltrina Biqkaj, Donjeta Halilaj dhe Edona Kryeziu.

"Dardanet" patën paraqitje të mirë. Dominuan që nga fillimi, por golin e epërsisë e arritën në minutën e 41-të nëpërmjet Erëleta Memetit. Kosova pati edhe disa raste në pjesën e parë, por nuk arriti t'i realizojë në gol. "Dardanet" nuk e ndryshuan ritmin as në pjesën e dytë, edhe pse trajnerja bëri ndryshime në formacion. Pak minuta pasi filloi kjo periudhë e lojës, Kosova përfitoi penallti në minutën 58, të cilën me



saktësi e ekzekutoi Feride Kastrati, për rezultat 2:0. Tre minuta më vonë Kaltrina Biqkaj e shtoi epërsinë në 3:0. Megjithatë, as kjo epërsi e lartë nuk i ndali dardanet, të cilat luajtën pa presion dhe në minutën e 87-të Jehona Shala shënoi nga penalltia për 4:0, me të cilin rezultat edhe

përfundoi takimi. Ndeshjen e dytë miqësore kundër Lihtenshtajnit, Kosova e zhvillon të dielën me fillim nga ora 11:30 po ashtu në Kampin Nacional në Hajvali. Këto miqësore i shërbejnë Kosovës të përgatitet për ndeshjet kualifikuese të Ligës së Kombeve që nisin në shtator.

Messi: Nëse nuk do të fitoja Botërorin, do të tërhiqesha nga ekipi kombëtar

MIAMI, 14 KORRIK - Lionel Messi ka zbuluar në Amerikë, ku do ta vijojë karrierën e tij me skuadrën e Inter Miami. Në pritje të prezantimit të tij ditën e diel, sulmuesi argjentinas ka rëfyer një sekret. Ai kishte vendosur të tërhiqej nga kombëtarja nëse do të dështonte edhe në Botërorin Katar 2022, ku ai u shpall kampion. "E kam shijuar të gjithë rrugëtimin tim në Botëror, sikur nuk kisha luajtur kurrë më parë në atë turne. Kjo edhe për faktin se e dija që mund të ishte hera e fundit që luaja në Kupën e Botës. Ndaj, të jem i singertë, nëse nuk do ta fitoja Botërorin, nuk do të luaja më me ekipin kombëtar", ka thënë Messi në televizionin publik argjentinas. Ndërkohë që shpallja kampion bote i dha më shumë motiv për të provuar edhe njëherë tjetër të fitojë Copa America, ndërsa



lë enigmë pjesëmarrjen në Kupën e Botës 2026. "Tani që jam kampion bote nuk mund ta lë kombëtaren. Më pëlqen ta shijoj këtë gjë. Gjatë Botërorit isha i qetë dhe i bindur te skuadra që kisha, pasi ishim përgatitur mirë. Tani do të luaj në Amerikë, ndaj mentaliteti im nuk

do të ndryshojë. Do të përpiqem të jap sërish më të mirën time, për veten dhe klubin ku do të luaj. Nuk mund të parashikoj çfarë do të ndodhë në 2026-n", ka shtuar Messi, i cili do të nisë një tjetër etapë të karrierës së tij, që po shkon drejt fundit.

SHKURT

Chelsea interesohet për Neymarin

Chelsea është e interesuar për ta sjellë Neymarin në "Stamford Bridge" këtë verë. Megjithatë, klubi anglez do të presë nëse braziliani është gati të kërkojë një largim nga Paris Saint-Germaini. 31-vjeçari ka ende katër vjet në kontratën e tij në "Parc des Princes", por kjo nuk i ka ndalur spekulimet për të ardhmen e tij. Sipas mediumit "Le Parisien", Neymar synonte të largohej nga klubi këtë verë me një transferim në Barcelonë. Megjithatë, që nga ardhja e ish-menaxherit të Barcelonës, Luis Enrique në PSG, tani ekziston mundësia që ai të vendosë të qëndrojë. Dyshja punuan së bashku në Spanjë dhe fituan një tripletë historike më 2015.

Rusia dhe Bjellorusia përjashtohen nga Lojërat e Parisit

Rusia dhe Bjellorusia nuk do të marrin një ftesë zyrtare për Lojërat Olimpike të Parisit 2024. Është një traditë e IOC-së pikërisht një vit përpara se të hapen Lojërat Verore ose Dimërore për të ftuar të gjitha ekipet kombëtare në mbarë botën në këtë eveniment sportiv. Pavarësisht prej lëvizjes së protokollit, disa atletë rusë dhe bjellorusë mund të konkurrojnë ende në Paris, pavarësisht prej përfshirjes së vendeve të tyre në luftën ndaj Ukrainës. Kjo mund të ndodhë vetë nëse atletët regjistrohen dhe konkurrojnë si neutralë dhe pa përfaqësuar simbolet e tyre përkatëse kombëtare.

Westbrook bëhet aksionar i Leedsit

Duket se investimet amerikane në futbollin anglez nuk kanë fund, ku aksionarë tashmë nuk po bëhen vetëm biznesmenët e njohur, por edhe shumë emra të mëdhenj të sportit. I fundit që pritet të bashkohet në këtë rrugëtim është Russell Westbrook. Ylli i Los Angeles Clippersit do të jetë pjesë e "49ers Group" që do t'i blejë aksionet e Leeds Unitedit, klubit që ra këtë sezon nga Premierë Liga në Championship. Një gjë të tillë e ka bërë më parë dhe LeBron Jamesi, i cili është pjesë e "RedBird Capital" kur kishte aksionet e Liverpoolit, teksa tani ka aksionet e Milanit.

Zbulohet plani i PSG-së për ta bindur Mbappen që të rinovojë

PSG-ja duket se ka një plan për ta bindur Kylian Mbappen që të rinovojë kontratën. Sulmuesi ka thënë disa herë se ka dëshirë të luajë për Real Madridin dhe duket se ka ndërmend të qëndrojë edhe një sezon në Paris, për t'u transferuar më pas me kosto zero në Madrid. Pavarësisht se nuk janë dakord dhe se kërkojnë vazhdimisht që lojtari të largohet këtë verë, duket se drejtuesit e ekipit francez Francës shpresojnë të një kthesë e bujshme nga lojtari. Sipas medias franceze "RmcSport", klubi shpreson të ndërhyrja e një ndërmjetësi që është shumë i afërm i familjes për ta bindur lojtarin që të qëndrojë dhe ta rinovojë kontratën. Bëhet fjalë për Ziad Hammoud, ish-bashkëpunëtor i grupit "BeIN Media", i cili përfaqëson prej pak muajsh lojtarin. Sipas burimit, Hammoud është një njeri shumë i rëndësishëm brenda familjes Mbappe dhe fjala e tij ka ndikim shumë të madh. Ajo e sulmuesit është një nga telenovelat e verës më intensive vitet e fundit, që duket se do të zgjasë edhe shumë. Megjithatë, PSG-ja nuk dorëzohet dhe shpreson të mrekullia.

Nani rikthehet në Turqi, nënshkruan për Adana Demirspor

Klubi turk Adana Demirspor zyrtarizoi në orët e vona të së enjtes nënshkrimin e portugezit Nani. 36-vjeçari, i njohur

ndërkombëtarisht për përvojën e tij te Manchester Unitedi në periudhën 2007-2014, ka firmosur kontratë të

vlefshme për një sezon, me opsion rinovimit edhe një vit tjetër. Kështu Nani është rikthyer në Turqi, ku ka përfaqësuar

Fenerbahçen në sezonin 2015/16, me një rekord prej 47 ndeshjesh dhe 12 golash. Nani është gjithashtu mes lojtarëve

me më shumë ndeshje në Kombëtaren e Portugalisë, pasi ka luajtur në 112 ndeshje dhe ka shënuar 24 gola.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bajram Berisha nga Barran i Ulët Pejë shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Adea Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.

Gentiana Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Arnesa Paçarizi nga malisheva shpall të pavlefshme dëftesën e kl së X të lëshuar nga shkolla "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Merlinda Sylja nga Molliqi, KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Sh.M. Mjekësisë "Hysni zajmi", Gjakovë.

- Alba Konjuhi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Së dhjetë (10) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Florian Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Florije Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. "Shaban Gola Lipovec KK Gjakovë, nga kl. 6-9.

- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Ibrahim Jakup Brahimi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. Dhjetë (10) dhe njëmbëdhjetë (11) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Ylli Berisha shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë (10) të Gjimnazit "Ahmet Gashi" Prishtinë.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 1,2,3,4 të QAMO-s, "Hajdar Dushi", Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Xhemil Gjini shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Olti Bajrami shpall te pavlefshme diplomën dhe certifikatën te CMSH QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Nevruz Gjocaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Valdet Asllani nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e QAMO "Nexhmedin Nixha".

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të sh.m. Muzikës "Prenk Jakova" Gjakovë.

- Dion Zeqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shf.m.u. "Selman Riza" nga kl. 6-9 Gjakovë.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Jozef Dodaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Jeta Meqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat 10.11.12 si dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

